

Shk. i Jancos Plamen
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

Nr. Prot 2922

Tiranë, 14 .10. 2025

Lenda: Kërkesë për interpelancë me Zv/kryeministren/ Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, Znj. Belinda Balluku

Drejtuar: Z. Niko Peleshi

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

I nderuar Zoti Kryetar,

Bazuar në nenin 80, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 96 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj interpelancë me zëvendëskryeministren njëherësh Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, Znj Belinda Balluku në lidhje me koncesionin “Për Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Aksit Rrugor “Thumanë – Vorë – Kashar”.

1. A ka llogaritur ministria juaj se cili është raporti mes investimit dhe fitimit të kompanisë përgjatë 35 viteve të operimit të aksit Thumanë- Kashar?

2. Cila është arsyeja e zgjatjes së këtij koncensionit, nga 13 vjet i kërkuar nga oferta e pakërkuar, në 35 vite nga ana e Qeverisë?
3. A do të përdorni të njëjtin model me akset e tjera, nga Kashari në Fier apo Thumanë-Balldren.

Mbetem në pritje të caktimit të datës së interpelancës në përputhje me afatet e përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Rregulloren e Kuvendit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Deputeti

Agron Shehaj

